



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E EKONOMISË ,KULTURËS DHE INOVACIONIT  
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE  
SHKOLLA E MESME PROFESIONALE “ KOLIN GJOKA”LEZHË

Nr. 384 prot.

Data 04.09 .2024

Lënda: Njoftim për vënd të lirë ( zev.raporte )

**AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE**

Në zbatim të ligjit nr. 15/2019, “Për nxitjen e punësimit”: të ligjit nr. 15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”: të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 554, datë 31.7.2019, “Përkrijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të punësimit dhe aftësive”: të udhëzimit nr.14, datë 27.05.2021, “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional”.

Shkolla Profesionale “Kolin Gjoka”,ju njofton krijimin e nje vendi të lire pune për pozicionin:

-Mësimdhënës të formimit teorik dhe praktik , drejtimi Hoteleri-Turizem.me kohe te plote. 1 (një) person **per periudhen e zevendesimit te mesueses me leje barrë lindje.**

**- Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme**

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme si vijon:

- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës se prerë për kryerjen e veprave penale;
- Të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- Të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- Të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe motivimit;

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

- Të ketë diplomë të nivelit master profesional ose të barazvlershme, në të njëjtën fushë me njërin nga kualifikimet profesionale të ofruesit të AFP-së;
- Të ketë të paktën 3 (tre) vjet eksperiencë pune në fushën,në te cilën ka kryer studimet;
- Të njohë dhe të përdore teknologjine e informacionit;

**1. Dokumentet e aplikimit**

Dosja e aplikimit,e cila përmban dokumentacionin e kërkuar sipas njoftimit të vendit të lirë të përfshijë:



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT**  
**AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE**  
**SHKOLLA E MESME PROFESIONALE "KOLIN GJOKA" LEZHË**

- Letër motivimin për pozicionin;
- jetëshkrimin(CV-në);
- kartën e identitetit;
- diplomën;
- librezën e punës;
- çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
- certifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- vërtetimin e gjendjes shëndetësore;
- vërtetimin e gjendjes gjyqësore;
- vërtetimin nga punëdhënësi i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi
- të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësit e mëparshëm.
- të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara;

Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuara.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e ofruesit të AFP-së brenda datës 13.09.2024

**DREJTORI**

**Bardh DEDGJONAJ**

